

AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË “PREMIUM DENTAL CLINIC” SH.P.K.

Me cilësinë e 1 (një) ortaku Themelues:

Unë **Ervin Gjergji**, i biri i Agim-it i datëlindjes 25.09.1984, lindur në Durrëa, dhe banues në Bashinë Durrës, Njësia Administrative Rrashbull, madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili me vullnetin e tij të lirë e të plotë, në cilësinë e ortakut të vetëm të mbështetur:

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në Ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare, në Ligjin “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojë këtë shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“PREMIUM DENTAL CLINIC” sh.p.k.**

KREU I

Themelimi, Emri, Personaliteti Juridik Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Vula

Neni 1

Data e Themelimi, Emri dhe Themeluesit

Sot më datën 25.03.2024 unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“PREMIUM DENTAL CLINIC” sh.p.k.**

Neni 2

Personaliteti Juridik

Shoqëria **“PREMIUM DENTAL CLINIC” sh.p.k.** është person juridik i të drejtës tregtare shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“PREMIUM DENTAL CLINIC” sh.p.k.** është një shoqëri që kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga 1 (një) ortak i vetëm i cili përballonë humbjen deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara.

Neni 3

Objekti

- Klinikë dentare, grafi dentare. Mjeksi estetike dhe dermatologjike..
- Zirkonium, terapi, ortopedi, kirurgji, ortodonci, implantologji dhe ekzaminime, eksport, import dhe tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve dhe medikamenteve, pajisjeve. Asistence teknike, mirembajtje dhe riparim te gjitha produkteve te permendura me siper. Laborator dentar, veprimtarite me burime te rezatimeve jonizuese,grafi dentare,panoramex,cefalometri,3D,intraorale.
- Turizëm Dentar .

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisëdo të jetë paafat.

Neni 5
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Usluga Gate Rruga “Asim Vokshi (Reshit Petrela)” Hyrja 2, Kati i katër^{te}, Tiranë, Shqipëri. Usluga Gate Rruga “Asim Vokshi (Reshit Petrela)” Hyrja 1, Kati i katër^{te}, Tiranë, Shqipëri.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektornik është :
e-mail:info@premiumdentalalbania.it

Neni 6
Vula

Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emri i Shoqërisë “**PREMIUM DENTAL CLINIC**” SH.P.K, TIRANË, SHQIPËRI”

KREU II
Kaptali

Neni 7
Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqindë mijë) Lekë dhe është i përbërë në (kuota), vlera nominale e të cilave është 1 000 lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku i vetëm themelues **Ervin Gjergji** : Zotërues I 100% kuotave me vlerë të përgjithshme që përbën 100 % të kapitalit.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme ose të drejta).

Neni 8
Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimisë
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj

KREU III
Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 10
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimin e statutit;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën c dhe d të kësaj pike;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asmblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara në ligj apo statut;

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asmblesë së përgjithshme e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Administrimi**

- 1- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimeve të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 3- Ortaku i vetëm caktohen si Administratorë i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme

EMËR MBIEMËR ADRESE
NËNSHKRIMIT

SPECIMENI

Neni 12 **Kompetencat e Administratorit**

Administratori kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijonë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbreëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgonë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
- g) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat financiare të certifikuara;
- shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV
Viti Financiar-Ekspertët

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

KREU V
Prishja-Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 14
Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është nftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me Ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30-ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 15
Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi-Ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 16
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje m zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndis Shoqërsë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PREMIUM DENTAL CLINIC" SH.P.K.

1) ERVIN GJERGJI

ERVIN GJERGJI

